

<p><i>Acquis</i> së BE-së që synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare) CELEX: 01991L0271-20140101 DIREKTIVA 91/271/KE TË PARLAMENTIT EUROPIAN DHE TË KËSHILLIT, datë 21 maj 1991 “Për trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane” <i>((OJ L 135, 30.5.1991, p. 40))</i></p>		<p>Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit) Projekt Ligj “Për Burimet Ujore” Shkalla e përafritimit (një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëri e plotë Përputhshmëri e pjesshme I papërputhur Shkalla e Përafritimit e pjesshme</p>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Në këtë kolonë shënohet vetëm numri i nenit të instrumentit të <i>acquis</i> së BE-së që përafrohet ose i paragrafit apo nënparagrafit.	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit që i korrespondon numri në kolonën e parë. Sipas rastit, çdo nen mund të copëzohet në paragrafë apo nënparagrafë, duke vendosur secilin në një rresht të veçantë.	Në rastin kur projektaktet që përafrohen janë më shumë se një, atëherë ato numërtohen dhe në këtë kolonë shënohet numri përkatës i referencës	Në këtë kolonë shënohet numri i nenit të projektaktit	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit, ose i pjesëve të nenit, që i korrespondon numri në kolonën e katërt dhe që ka përafruar kërkesat e nenit të <i>acquis</i> së BE-së në kolonën e dytë.	Në këtë kolonë shënohet shkalla e përafritimit për çdo nen të veçantë.	Në këtë kolonë jepen shënime në lidhje me shkallën e përafritimit. Kur përafritimi nuk është i plotë, jepen arsyet dhe afatet se kur do të bëhet përafritimi i plotë.
Neni 2, pika 1	‘ujëra të ndotura urbane’ do të thotë ujëra të ndotura shtëpikë ose përzjerja e ujërave të ndotura shtëpikë me ujëra të ndotura industriale dhe/ose rrjedhje të shiut;		Neni 3, pika 107	“Ujëra të ndotura urbane” janë ujërat e ndotura shtëpikë ose përzjerja e ujërave të ndotura shtëpikë me ujërat e ndotura industriale ose ujërat rrjedhëse të reshjeve.	plotë	

Neni 2, pika 2	‘ujëra të ndotura shtëpiake’ do të thotë ujë nga vendbanimet rezidenciale dhe shërbime që e kanë origjinën kryesisht nga metabolizmi i njeriut dhe aktivitetev shtëpiake;		Neni 3, pika 106	“Ujëra të ndotura shtëpiake” janë ujërat e përdorura nga zonat rezidenciale dhe sektori i shërbimeve, që e kanë origjinën kryesisht nga metabolizmi i njeriut dhe veprimtaritë familjare.	plotë	
Neni 2, pika 3	‘ujëra të ndotura industriale’ do të thotë cdo ujë i ndotur i cili shkarkohet nga ndërtesat që përdoret për të kryer cdo tregti apo industri, të tjera nga urjat e ndotura shtëpiake dhe rrjedhjet e shiut;		Neni 3, pika 105	“Ujëra të ndotura industriale” është çdo sasi uji që shkarkohet nga objekte që përdoren për të zhvilluar veprimtari tregtare ose industriale, përveç ujërave të ndotura shtëpiake dhe ujërave të reshjeve.	plotë	
Neni 2, pika 4	‘aglomerat/grumbullim’ do të thotë një zonë ku ndotja dhe/ose aktiviteti ekonomik janë të përqëndruara mjaftueshëm që të mblidhen ujërat e ndotura urbane dhe të drejtohen në një impiant trajtimi të urjrave të ndotura ose në një pikë përfundimtare shkarkimi;		Neni 3, pika 1	1. “Aglomerat” është një zonë ku popullsia dhe veprimtaritë apo një prej tyre janë të përqëndruara në atë masë sa lejojnë që ujërat e ndotura urbane të mblidhen dhe të drejtohen në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura urbane ose në një pikë fundore shkarkimi.	plotë	
Neni 2, pika 5	‘sistemi i grumbullimit’ do të thotë një sistem më kanale/përcues të cilay mbledhin dhe përcjellin ujërat e ndotura urbane;		Neni 3, pika 67	“Sistem kolektor” është një sistem kanalizimesh që mbledh dhe transporton ujërat e ndotura urbane.	plotë	
Neni 2, pika 6	e.p ‘(ekuivalenti i popullsisë)’ do të thotë ngarkesa organike e biodegradueshme që ka një kërkesë 5 ditore për oksigjen (BOD5) prej 60g oksigjen në ditë;		Neni 3, pika 44	“nj.p.(Një popullsi ekuivalent)” është ngarkesa organike që shpërbëhet biologjikisht dhe që ka kërkesë bio-kimike oksigjeni pesë ditore (BOD5) prej 60g oksigjen në ditë.	plotë	
Neni 2, pika 7	‘trajtimi primar’ do të thotë trajtimi i ujërave të ndotura urbane nga një proces fizik		Neni 3, pika 92	“Trajtim parësor” është trajtimi i ujërave të ndotura urbane përmes një procesi fizik ose kimik apo	plotë	

	dhe/ose kimik duke përfshirë shlyerjen e matrialeve të ngurtave të pezulluara, ose procese të tjera ku BOD5 e ujërave të ndotura hyrëse reduktohet me të paktën 20% përpara shkarkimit dhe të ngurtat totalë të pezulluara të ujërave të ndotura hyrëse reduktohen me të paktën 50%.			përmes të dyja këtyre proceseve që përfshin dekantimin e lëndës së ngurtë pezull, ose procese të tjera përmes të cilave BOD5 e ujërave të ndotura hyrëse pakësohet me të paktën 20% përpara shkarkimit dhe lëndës së ngurtë pezull e përgjithshme e ujërave të ndotura hyrëse pakësohet me të paktën 50%.		
Neni 2, pika 8	‘trajtimi sekondar’ do të thotë trajtimi i ujërave të ndotura urbane nga një proces që zakonisht përfshin trajtim biologjik me një vendndoshje sekondare ose proces tjetër në të cilin respektohen kërkesat e përcaktuara në Tabelën 1, Aneks I;		Neni 3, pika 90	“Trajtim dytësor” është trajtimi i ujërave të ndotura urbane përmes një procesi që në përgjithësi përfshin trajtimin biologjik përmes dekantimit dytësor apo proceseve të tjera që përmbushin kërkesat e përcaktuara në zbatim të neneve 97, 98, 99, 100 dhe 107 të këtij ligji.	plotë	
Neni 2, pika 9	‘trajtim i duhur/përshtatshëm’ do të thotë trajtimi i ujërave të ndotura urbane me çfarëdolloj procesi dhe/ose sistemi asgjësimi të cilët pas shkarkimit lejojnë që urjat marrëse të plotësojnë objektivat përkatëse të cilësisë dhe dispozitat përkatëse të kësaj Direktive dhe të Direktivave të tjera të Komunitetit;		Neni 3, pika 91	“Trajtim i përshtatshëm” është trajtimi i ujërave të ndotura urbane me anë të çdo procesi ose sistemi largimi që pas shkarkimit i mundëson ujërave pritëse të përmbushin objektivat përkatëse të cilësisë mjedisore dhe dispozitat e këtij ligji dhe akteve të tjera përkatëse.	plotë	
Neni 2, pika 10	‘Llum’ do të thotë llum i mbetur, qoftë i trajtuar apo i patrajtuar, nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane;		Neni 3, pika 33	“Llum” është mbetja e trajtuar ose e patrajtuar e llumit nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane.	plotë	

Neni 2, pika 11	‘eutrofikim’ do të thotë pasurimi i ujit me ushqyes, veçanërisht përbërës të nitrogenit dhe/ose fosforit, duke shkaktuar një rritje të përshpejtuar të algave dhe forma më të larta të jetës së bimëve që të prodhojnë një shqetësim të padëshirueshëm në balanat e organizmave që janë prezentë në ujë dhe për cilësinë e ujit në fjalë;		Neni 3, pika 17	“Eutrofikim” është pasurimi i ujit me elemente ushqyes, veçanërisht me komponime të fosforit dhe azotit, çka shkakton zhvillim të shtuar të algave dhe llojeve të bimëve ujore, që krijojnë shqetësim të padëshirueshëm të bilancit të organizmave të pranishëm në ujë dhe të cilësisë së ujit në fjalë. Për qëllimet e zbatimit të neneve 111 - 117 të këtij ligji, përkufizimi i termit “eutrofikim” përfshin vetëm komponimet e azotit.	plotë	
Neni 2, pika 12	‘rezervuar i gjërë/grykëderdhje e gjërë’ do të thotë zona e përkoshme në daljen e një lumi midis ujit të paster dhe ujërave detare. Shtet Anëtarë duhet të krijojnë limitet e jashtme të rezervuareve për qëllimin e kësaj Direktive si pjesë e programit për implementimin në përputhje me dispozitat e Nenit 17(1) dhe (2);		Neni 3, pika 16	“Estuar” është zona kalimtare në grykëderdhjen e një lumi midis ujërave të ëmbla dhe ujërave bregdetare.	plotë	
Neni 2, pika 13	‘ujërat bregdetare’ do të thotë ujërat jashtë vijës së ulët të ujit ose limiti i jashtëm i një rezervuari.		Neni 3, pika 100	“Ujëra bregdetare” janë ujërat sipërfaqësorë, të cilat ndodhen në brendësi të një vije imagjinare, e cila është e barazlarguar në secilën nga pikat e saj 1 milje detare nga pjesa e jashtme e pikës më të afërt të vijës bazë dhe që shërben si referim për të përcaktuar shtrirjen e ujërave territoriale dhe që	plotë	

				shtrihen rrjedhimisht deri në kufirin e jashtëm të ujërave tranzitore. Për qëllimet e zbatimit të neneve 96 - 110 të këtij ligji, termi “ujëra bregdetare” ka kuptimin e ujërave jashtë vijës së ulët të ujit apo kufirit të jashtëm të një estuari.		
Neni 3, pika 1, fjalia e 2-të	Për ujërat e ndotura urbane që shkarkohen në ujëra marrëse të cilat janë konsideruar ‘zona të ndjeshme’ sic përcaktohet në Nenin 5, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që sistemet e grumbullimit të sigurohen jo më vonë se 31 Dhjetor 1998 për aglomeratet me më shumë se 10 000 e.p.		Neni 3, pika 116	“Zonë e ndjeshme” janë trupat ujorë të identifikuar në përputhje me nenin 99 të këtij ligji.	plotë	Referenca e vendosur në fjalinë e dytë të pikës së parë të nenit 3, është transpozuar nga neni 99 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 10
Neni 6, pika 1	Për qëllimet e paragrafit 2, Shtetet Anëtare deri më 31 Dhjetor 1993 mund të identifikojnë zonat më pak të ndjeshme sipas kriterëve të përcaktuara në Aneksin II.		Neni 3, pika 117	“Zonë më pak e ndjeshme” janë trupat ujorë të identifikuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në përputhje me nenin 100 të këtij ligji.	plotë	
Neni 1	Kjo Direktivë ka të bëjë me mbledhjen, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura urbane dhe trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura nga disa sektorë industrial. Objektivi i kësaj direktive është që të mbrojë mjedisin nga efektet negative nga shkarkimet e ujërave të ndotura të lart përmendura.		Neni 96	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, autoritetet përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe autoritete të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, furnizimin me ujë dhe kanalizime si dhe për bujqësinë janë përgjegjëse për veprimtaritë e përcaktuara në nenet 97-126 të këtij ligji, me qëllim mbrojtjen e mjedisit nga efektet negative të shkarkimit të ujërave të ndotura	plotë	

				urbane, të grumbulluara dhe të trajtuara, si dhe të shkarkimit të ujërat e ndotura industriale të trajtuara.		
Neni 3, pika 1, paragrafi i parë	<p>1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të gjitha aglomeratet të sigurohen me sistemet e grumbullimit për ujërat e ndotura urbane,</p> <ul style="list-style-type: none"> - jo më vonë se 31 Dhjetor 2005 për ato me një popullsi ekuivalente me më shumë se 15 000 dhe - jo më vonë se 31 Dhjetor 2005 për ato me një popullsi ekuivalente midis 2000 dhe 15 000. 		Neni 97, pika 1	<p>1. Autoritetet përkatëse të vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin të sigurojnë se për të gjitha aglomeratet të ketë një sistem kanalizimesh për ujërat e ndotura urbane:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) jo më vonë se 15 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për ato me njëvlerës popullsie (nj.p) më të madh se 15.000; dhe b) jo më vonë se 10 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për ato me nj.p. nga 2.000 deri në 15.000. 	plotë	
Neni 3, pika 1, paragrafi i dytë	Për ujërat e ndotura urbane që shkarkohen në ujëra marrëse të cilat janë konsideruar 'zona të ndjeshme' sic përcaktohet në Nenin 5, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që sistemet e grumbullimit të sigurohen jo më vonë se 31 Dhjetor 1998 për aglomeratet me më shumë se 10 000 e.p.		Neni 97, pika 2	Autoritetet përkatëse të vetëqeverisjes vendore sigurohen që sistemi i kanalizimeve i ujërave të ndotura urbane që shkarkohen në ujërat pritëse, të cilat konsiderohen si "zona të ndjeshme" në kuptim të këtij ligji, është funksional për aglomerate me nj.p. më të madh se 10.000, jo më vonë se 8 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	plotë	
Neni 3, pika 1, paragrafi i tretë	Kur krijimi i një sistemi të grumbullimit nuk është i justifikuar ose sepse nuk do të prodhonte përfitime për mjedisin ose sepse do të përfshinte kosto të tepërta,		Neni 97, pika 3	3. Kur ndërtimi i sistemit të kanalizimeve nuk justifikohet pasi nuk do të kishte përfitime mjedisore, ose do të kërkonte kosto shtesë, autoritetet përkatëse të njësive të vetëqeverisjes	plotë	

	duhet të përdoren sisteme individuale ose sisteme të tjera të përshtatshme të cilat arrijnë të njëjtin nivel të mbrojtjes së mjedisit.			vendore sigurohen që do të përdoren sisteme individuale apo sisteme të tjera të përshtatshme që arrijnë të njëjtin nivel mbrojtjeje mjedisore.		
Neni 3, pika 2	Sistemet e grumbullimit të përshkruara në paragrafin 1 duhet të përbushin kërkesat e Aneksit I (A). Këto këkesa mund të ndryshohen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Nenin 18.		Neni 97, pika 4 dhe 5	4. Kërkesat dhe standardet për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimeve sipas këtij neni, përcaktohen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për ujësjellës kanalizimet. 5. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton kërkesat dhe standardet për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimeve, sipas pikës 4 të këtij neni, brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	pjesshëm	Pika 5 krijon bazën ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor i cili do të traspozohet pikën 2 të nenit 3 të Direktivës, rrjedhimisht Shtojcën I, pjesa A.
Neni 4, pika 1 paragrafi i parë	1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ujërat e ndotura urbane që futen në sistemet e grumbullimit përpara shkarkimit duhet të jenë subjekt I trajtimit sekondar ose një trajtimi ekuivalent si më poshtë: - Jo më vonë se 31 Dhjetor 2000 për të gjitha shkarkimet për aglomerate me më shumë se 15 000 e.p.		Neni 98, pika 1 gërma (a)	1. Autoritetet përkatëse të vetëqeverisjes vendore sigurohen që ujërat e ndotura urbane të cilat hyjnë në sistemet e kanalizimeve t'i nënshtrohen përpara shkarkimit trajtimit dytësor apo një prej trajtimeve të barasvlershme: a) jo më vonë se 20 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për të gjitha shkarkimet nga aglomeratet me nj.p. më të madh se 15.000;	plotë	

Neni 4, pika 1 paragrafi i dytë	- Jo me vonë se 31 Dhjetor 2005 për të gjitha shkarkimet për aglomerate midis 10 000 dhe 15 000 e.p.		Neni 98, pika 1 gërma (b)	b) jo më vonë se 15 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për të gjitha shkarkimet nga aglomeratet me nj.p. nga 10.000 deri në 15.000;	plotë	
Neni 4, pika 1 paragrafi i tretë	- Jo me vonë se 31 Dhjetor 2005 për shkarkimet në ujë të pastër dhe rezervuare për aglomerate midis 2 000 dhe 10 000 e.p.		Neni 98, pika 1 gërma (c)	c) jo më vonë se 10 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për të gjitha shkarkimet nga aglomeratet me nj.p. nga 2.000 deri në 10.000;	plotë	
Neni 4, pika 2	2. Shkarkimet e ujërave të ndotura urbane me vendodhje në rajone të larta malore (mbi 1 500 m mbi nivelin e detit) ku është e vështirë të aplikohet një trajtim efektiv biologjik për shkak të temperaturave të ulëta mund të jenë subjekt I një trajtimi më pak të rreptë se sa ai i përshkruar në paragrafin 1, duke siguruar që studime të detajuara tregojnë që shkarkime të tilla nuk ndikojnë negativisht mjedisin.		Neni 98, pika 2	2. Shkarkimet e ujërave të ndotura në trupa ujqorë që ndodhen në rajone të larta malore mbi 1.500 m mbi nivelin e detit, ku është e vështirë të kryhet trajtimi biologjik për shkak të temperaturave të ulëta, mund t'u nënshtrohen trajtimeve më pak shtrënguese se ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, me kusht që studimet e detajuara të provojnë se këto shkarkime nuk ndikojnë negativisht në mjedis.	plotë	
Neni 4, pika 3	3. Shkarkimet nga impimantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane përshkruar në paragrafët 1 dhe 2 duhet të përmbushin kërkesat përkatëse të Aneksit I.B. Këto kërkesa mund të ndryshohen në përputhje me procedurat e parashtuara në Nenin 18.		Neni 98, pika 3 dhe 4	3. Kriteret e shkarkimit të ujit të trajtuar nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane të përshkruara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, hartohen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për ujësjellës kanalizimet.	pjesshëm	Pika 4 krijon bazën ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor i cili do të traspozohet pikën 3 të nenit 4 të Direktivës, rrjedhimisht Shtojcën I, pjesa B.

				4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton kriteret e shkarkimeve nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, sipas pikës 3 të këtij neni, brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.		
Neni 5, pika 1	Për qëllimin e paragrafit 2, Shtetet Anëtare deri me 31 Dhjetor 1993 duhet të identifikojnë zonat e ndjeshme sipas kritereve e përcaktuara në Aneksin II.		Neni 99, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore identifikon të gjitha zonat e ndjeshme në çdo rajon baseni lumor apo liqenor në territorin e Shqipërisë.	plotë	
Neni 5, pika 2	Shtete Anëtare duhet të sigurojnë që ujërat e ndotura urbane që futen në sistemet e grumbullimit përpara shkarkimit në zonat e ndjeshme duhet të jenë subjekt I trajtimeve më të rrepta se sa ato të përshkruara në Nenin 4, jo më vonë se 31 Dhjetor 1998 për të gjitha shkarkimet nga agglomerate me më shumë se 10 000 p.e.		Neni 99, pika 4	4. Autoritetet kompetente të NjVV-së sigurohen që ujërat e ndotura urbane që hyjnë në sistemet e kanalizimeve, përpara se të shkarkohen në zonat e ndjeshme, t'u nënshtrohen trajtimeve më shtrënguese se ato të parashikuara në nenin 98 të këtij ligji, jo më vonë se 15 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për të gjitha shkarkimet nga agglomerate me nj.p. më të madh se 10.000.	plotë	Referenca e vendosur në nenin 5, pika 2 e Direktivës (neni 4) është transpozuar plotësisht nga projektligji (neni 98)
Neni 5, pika 3	Shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura të përshkruara në paragrafin 2 duhet të përmbushin kërkesat përkatëse të Aneksit I B. Këto kërkesa mund të ndryshohen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Nenin 18.		Neni 99, pika 5	5. Shkarkimi i ujit të trajtuar nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane të cilat kryhen në ujëra pritëse që konsiderohen si zona të ndjeshme, në përputhje me parashikimet e pikës 2 të nenit 97, duhet të plotësojnë kriteret e	plotë	

				përcaktuara në përputhje me nenin 98 të këtij ligji.		
Neni 5, pika 4	Si alternativë, kërkesat për impiante individuale të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 me lart nuk aplikohen në zona të ndjeshme ku mund të tregohet që përqindja minimale e reduktimit të ngarkesës së përgjithshme që futet në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në atë zonë është të paktën 70% për fosforin total dhe të paktën 75% për nitrogenin total.		Neni 99, pika 6	6. Kërkesat për impiantet individuale të përcaktuara sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 97 të këtij ligji, mund të mos zbatohen për ato zona të ndjeshme për të cilat tregohet se përqindja minimale e reduktimit të ngarkesës së përgjithshme që hyn në të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në atë zonë është të paktën 75% e fosforit total dhe të paktën 75% e azotit total.	plotë	
Neni 5, pika 5	Shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura të cilat janë të pozicionuara në zonat përkatëse të ujëmbledhjes të zonave të ndjeshme dhe të cilat kontribuojnë në ndotjen e kësaj zone duhet të jetë subjekt I paragrafeve 2,3 dhe 4.		Neni 99, pika 7	7. Shkarkimi i ujit të trajtuar nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, të cilat ndodhen në zonën përkatëse ujëmbledhëse të zonave të ndjeshme dhe që kontribuojnë në ndotjen e këtyre zonave janë subjekt i pikave 2 deri 4 të këtij neni.	plotë	
Neni 5, pika 6	Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që identifikimi I zonave të ndjeshme rishikohet në interval jo më shumë se katër vjet.		Neni 99, pika 2	2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron që identifikimi i zonave të ndjeshme të rishikohet në intervale kohore jo më të gjata se 4 vjet.	plotë	
Neni 5, pika 7	Shetet Anëtare duhet të sigurojnë që zonat e identifikuara si të ndjeshme duke ndjekur rishikimin sipas paragrafit 6 duhet të plotësojnë kërkesat e lart përmendura brenda 7 viteve.		Neni 99, pika 3	3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron që zonat e identifikuara si zona të ndjeshme sipas rishikimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni të plotësojnë kërkesat e pikave 2, 4 dhe 5 të këtij neni	plotë	

				brenda 7 vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.		
Neni 5, pika 8	Një shtet Anëtar nuk ka nevojë të identifikojë zonat e ndjeshme për qëllim të kësaj Direktive nëse implementon trajtimin e përcaktuar në paragrafët 2, 3 dhe 4 në të gjithë territorin e tij.		Neni 99, pika 10	10. Identifikimi i zonave të ndjeshme për qëllimet e këtij kreu nuk është i nevojshëm nëse trajtimi i ujërave të ndotura sipas përcaktimeve nga pika 2 deri 5 të këtij neni, kryhet në të gjithë territorin e Shqipërisë.	Plotë	
Shtojca II, pjesa A	II. Kriteret për identifikimin e zobave të ndjeshme dhe me pak të ndjeshme, A.Zonat e ndjeshme		Neni 99, pika 8	8. Kriteret për identifikimin e zonave të ndjeshme përcaktohen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Kryeministrit, brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	Pjesshëm	Pika 8, krijon bazën ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor i cili do të transpozojë plotësisht Shtojcën II pjesën A të Direktivës
Neni 6, pika 1	Për qëllimet e paragrafit 2, Shtetet Anëtare deri më 31 Dhjetor 1993 mund të identifikojnë zonat më pak të ndjeshme sipas kriterëve të përcaktuara në Aneksin II.		Neni 100, pika 1, fjalia e parë dhe pika 4	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore identifikon zonat më pak të ndjeshme në çdo rajon baseni lumor apo liqenor në territorin e Republikës së Shqipërisë. 4. Kriteret për identifikimin e zonave më pak të ndjeshme përcaktohen nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Kryeministrit, brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	Pjesshëm	Pika 4, krijon bazën ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor i cili do të transpozojë plotësisht Shtojcën II pjesën B të Direktivës

Neni 6, pika 2, paragrafi i parë	Shkarkimet e ujërave të ndotura urbane nga aglomerate midis 10 000 dhe 150 000 p.e. në ujëra detare dhe nga ato aglomerate midis 2 000 dhe 10 000 p.e në rezervuarë të pozicionuat në zonat e përshkruara në paragrafin 1 mund të jenë subjekt i një trajtimi më pak të rreptë sesa ai i përshkruar në Nenin 4 duke siguruar që: - Këto shkarkime marrin të paktën trajtimin orimar sic është përcaktuar në Nenin 2 (7) në konformitet me procedurat e kontrollit përcaktuar në Aneksin I D,		Neni 100, pika 2, germa (a)	2. Ujërat e ndotura urbane të shkarkuara nga aglomerate me nj.p. midis 10.000 dhe 150.000 në ujërat bregdetare dhe ato të shkarkuara nga aglomerate me nj.p. midis 2.000 dhe 10.000 në estuare që ndodhen në zonat e identifikuar sipas pikës 1 të këtij neni mund t'i nënshtrohen një trajtimi më pak shtrëngues se ai që parashikohet në nenin 98 të këtij ligji, me kusht që: a) këto shkarkime t'i nënshtrohen të paktën trajtimit parësor;	plotë	Referenca e vendosur në nenin 6, pika 2, paragrafi i parë (neni 2 (7)) është transpozuar plotësisht nga parashikimet e projektligjit (neni 3 pika 92 e projektligjit)
Neni 6, pika 2, paragrafi i dytë	- Studime gjithëpërfshirëse 12nterval që këto shkarkime nuk do të ndikojnë negativisht në mjedis.		Neni 100, pika 2, germa (b)	b) studimet të tregojnë se këto shkarkime nuk ndikojnë negativisht në mjedis.	plotë	
Neni 6, pika 4	Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që identifikimi i zonave më pak të ndjeshme rishikohet në 12ntervale jo më shumë se katër vjet.		Neni 100, pika 1, fjalia e dytë	Identifikimi i zonave më pak të ndjeshme rishikohet në intervale kohore jo më të gjata se 4 vjet.	plotë	
Neni 6, pika 5	Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që zonat që nuk identifikohen më si zona më pak të ndjeshme duhet të përmbushin brenda 7 viteve kërkesat e Neneve 4 dhe 5 si të jetë më e përshtatshme.		Neni 100, pika 3	3. Për ato zona të cilat nuk identifikohen më si zona më pak të ndjeshme, ujërat e ndotura urbane të shkarkuara i nënshtrohen kërkesave të parashikuara në nenin 98 të këtij ligji, brenda 7 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	plotë	

Neni 7, paragrafi i parë	Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë deri më 31 Dhjetor 2005 që ujërat e ndotura urbane që futen në sitemet e grumbullimit përpara shkarkimit duhet të jenë subjekt i trajtimit të duhur sic përcaktohet në Nenin 2 (9) në rastet e mëposhtme: - për shkarkime në ujë të pastër dhe rezervuare nga agglomerate me më pak se 2000 e.p.		Neni 101, germa (a)	Autoritetet përkatëse të vetëqeverisjes vendore sigurohen që brenda 10 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ujërat e ndotura urbane që hyjnë në sitemet e kanalizimeve, përpara shkarkimit, t'i nënshtrohen trajtimit të përshtatshëm, në rastet e mëposhtme: a) për shkarkime në ujëra të ëmbla dhe estuare nga aglomeratet me nj.p. më të vogël se 2.000;	plotë	Referenca e vendosur në nenin 7, paragrafi i parë i Direktivës (Nenin 2 (9)) është transpozuar plotësisht nga parashikimet e projektligjit. (neni 3 pika 91 e projektligjit)
Neni 7, paragrafi i dytë	- për shkarkime në ujëra detare nga agglomerate me më pak se 10 000 e.p.		Neni 101, germa (b)	b) për shkarkime në ujëra bregdetare nga aglomeratet me nj.p. më të vogël se 10.000.	plotë	
Neni 8, pika 1	Shtetet Anëtare, në raste të vecanta për shkak të problemeve teknike dhe për grupe popullsie të përcaktuara gjeografikisht, mund ti dorëzojë Komisionit një kërkesë të vecantë për një periudhë më të gjatë për të përmbushur Nenin 4.		Neni 102, pika 1	Në raste përjashtimore, afatet kohore të përcaktuara sipas pikës 1, të nenit 98 të këtij ligji, mund të zgjaten për shkak të problemeve teknike dhe për agglomerate të caktuara, por në çdo rast jo më shume se 10 vite nga afati i parashikuar sipas nenit 98 të këtij ligji.	plotë	Referenca e vendosur në nenin 8 pika 1 Direktivës (neni 4) është transpozuar plotësisht nga parashikimet e projektligjit (neni 98)
Neni 8, pika 2	Kjo kërkesë, arsyet e të cilës duhet të parashtrohen sic duhet, duhet të përcaktojë vështirësitë e hasura teknike dhe duhet të propozojë një program veprimi me një afat kohor të përshtatshëm që do të ndërmerret për të implementuar objektivat e kësaj Direktive. Ky afat kohor duhet të përfshihet		Neni 102, pika 2	2. Në çdo rast, zgjatja e afateve sipas përcaktimeve të nenit 1 të këtij ligji, duhet të shoqërohet me një raport, të përgatitur nga ministria përgjegjëse për ujësjellës kanalizimet, i cili përmban arsyet e vështirësive teknike të hasura dhe propozimin e një programi	plotë	

	në programin e implementimit referuar në Nenin 17.			veprimi me një afat kohor të rishikuar.		
Neni 8, pika 3	Mund të pranohen vetëm arsyet teknike dhe periudha e zgjatur referuar në paragrafin 1 nuk mund të tejkalojë 31 Dhjetor 2005.		Neni 102, pika 1	Në raste përjashtimore, afatet kohore të përcaktuara sipas pikës 1, të nenit 98 të këtij ligji, mund të zgjaten për shkak të problemeve teknike dhe për aglomerate të caktuara, por në çdo rast jo më shumë se 10 vite nga afati i parashikuar sipas nenit 98 të këtij ligji.	plotë	
Neni 8, pika 5	5. Në rrethana të vecanta, ku mund të vërtetohet që një trajtim më I avancuar nuk do të prodhojë ndonjë përfimit mjedisor, shkarkimet të ujërave të ndotura në zona më pak të ndjeshme nga aglomerate me më shumë se 15 000 e.p. mund të jenë subjekt i trajtimit të parashikuar në Nenin 6 për ujëra të ndotura nga agglomerate midis 10 000 dhe 150 000 e.p.		Neni 102, pika 3	3. Në rrethana të jashtëzakonshme, kur provohet se trajtimi më i avancuar nuk do të sillte përfitime mjedisore shkarkimet e ujërave të ndotura nga aglomeratet me nj.p. më të vogël se 150.000 në zonat më pak të ndjeshme mund t'i nënshtrohen trajtimit të parashikuar në nenin 116 të këtij ligji për ujërat e ndotura nga aglomerate me nj.p. midis 10.000 dhe 150.000.	plotë	
Neni 9	Kur ujërat brenda zones së juridiksionit të një Shteti Anëtar ndikohen negativisht nga shkarkimet e ujërave të ndotura urbane të një Shteti tjetër Anëtar, Shteti Anëtar të cilit i janë ndikuar ujërat mund të njoftojë Shetin tjetër Anëtar dhe Komisionin për faktet përkatëse. Shtetet Anëtare në lidhje me këtë duhet të organizojnë, kur		Neni 103	1. Kur burimet ujore në juridiksionin e Shqipërisë janë ndikuar negativisht nga shkarkimet e ujërave urbane të një shteti tjetër, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore i kërkon ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme që ta njoftojë shtetin tjetër për këtë fakt ose t'i kërkojë bashkëpunim për identifikimin e shkarkimeve në fjalë dhe të masave që duhen	plotë	

	është e përshtatshme me Komisionin, bashkëbisedimin e nevojshëm për të identifikuar shkarkimet në fjalë dhe masat që duhet të merren në burim për të mbrojtur urjat që janë ndikuar në mënyrë që të sigurohet konformiteti me dispozitat e kësaj Direktive.			ndërmarrë në burim për mbrojtjen e ujërave që janë ndikuar. 2. Pika 1 e këtij neni gjen zbatim edhe në rastet e shkarkimit të ujit të trajtuar nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, të cilat ndodhen plotësisht ose pjesërisht në një shtet tjetër në zonën përkatëse ujëmbledhëse të zonës së ndikuar dhe kontribuojnë në ndotjen e këtyre zonave.		
Neni 10	Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane të ndëruara për të përbushur kërkesat e Neneve 4, 5, 6 dhe 7 janë projektuar, ndërtuar, operuar dhe mirëmbajtur për të siguruar performancë të mjaftueshme nën të gjitha kushtet normal klimaterike. Kur projektohen impiantet duhet të merren në konderatë variacionet e stinëve të ngarkesave.		Neni 104	1. Autoritetet përkatëse të vetëqeverisjes vendore sigurohen që impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, të ndërtuara në zbatim të neneve 98-101 të këtij ligji, të jenë projektuar, ndërtuar dhe të operojnë e mirëmbahen për të siguruar funksionim të kënaqshëm në kushte normale klimatike të zonës. 2. Gjatë projektimit të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura merren parasysh edhe prurjet nga luhatjet e stinës.	plotë	
Neni 11, pika 1	Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që, përpara datës 31 Dhjetor 1993, shkarkimet e ujërave të ndotura industriale në sistemet e grumbullimit dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane janë subjekt i rregulloreve paraprake dhe/ose		Neni 105	Veprimtaria e shkarkimit të ujërave të ndotura industriale në sistemet e kanalizimeve dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane është subjekt i dhënies së lejes mjedisore, nga autoriteti përgjegjës, e cila përfshin edhe kërkesat e	plotë	

	autorizimeve specifike nga autoriteti kompetent ose organi i duhur.			përcaktuara nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në përputhje me dispozitat e neneve 79 - 95 të këtij ligji lidhur me vlerat kufi të emetimeve.		
Neni 12, pika 1	1.Uji i ndotur i trajtuar duhet të ri përdoret kurdo që të jetë e përshtatshme. Rrugët e asgjësimit duhet të minimizojnë efektete negative në mjedis.		Neni 106, pika 1	1. Uji i trajtuar nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotur urbanë do të ripërdoret kurdo që shihet e përshtatshme.	plotë	
Neni 12, pika 2	2.Autoritetet kompetente ose organet e caktuara duhet të sigurojnë që asgjësimi I ujërave të ndotura nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane është subjekt I rregulloreve paraprake dhe/ose autorizimeve specifike.		Neni 106, pika 2	2. Uji i trajtuar nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotur urbanë lejohet të shkarkohet në mjedis pritës vetëm me leje apo autorizim nga organet e menaxhimit të burimeve ujore. Gjithashtu gjatë miratimit të lejeve apo autorizimeve mjedisore, për operimin e këtyre impianteve organet kompetente duhet të përfshijnë edhe kërkesat e përcaktuara nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, lidhur me vlerat kufi të shkarkimeve, në përputhje me dispozitat e neneve 79-95 të këtij ligji.	plotë	
Neni 12, pika 3	3.Rregulloret paraprake dhe/ose autorizimet specifike të shkarkimeve nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane I bëre në përputhje me paragrafin 2 brenda		Neni 106, pika 3	3. Leja apo autorizimi mjedisor i përmendur në pikën 2 të këtij neni, që ka të bëjë me shkarkimet e ujit të trajtuar nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotur urbanë, në ujëra të ëmbla	plotë	

	aglomerateve nga 2 000 deri 10 000 e.p in rastin e shkarkimeve në uje të paster dhe rezervuare dhe të 10 000 e.p. ose më shumë në lidhje më të gjitha shkarkimet, duhet të përmbajë kushte që plotësojnë kërkesat përkatëse të Aneksit I B. Këto kërkesa mund të ndryshohen në përputhje më procedurat e përcaktuara në Nenin 18.			dhe estuare për aglomerate me nj.p nga 2.000 deri në 10.000 në rast dhe shkarkime tek të gjitha llojet e mjediseve pritëse për aglomerate më të mëdha ose të barabartë me 10.000 nj.p, duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara sipas neneve 97 deri 101 të këtij ligji.		
Neni 13, pika 1	1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që deri më datë 31 Dhjetor 2000 ujërat e ndotura industriale të biodegradueshme nga impiante që I përkasin sektorit industrial renditur në Aneksin III të cilat nuk futen në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane përpara shkarkimit në ujërat marrëse përpara shkarkimit duhet të respektojnë kushtet e përcaktuara nga autoritetet kompetente ose organet përkatëse në rregulloret dhe/ose autorizime specifike paraprake, në lidhje më të gjitha shkarkimet nga impiantet që përfaqësojnë 4 000 e.p ose më shumë.		Neni 107, pika 1, 2, dhe 3	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin përcaktojnë listën e industrive që gjenerojnë ujëra të ndotura me ngarkesë organike. 2. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton listën e industrive sipas pikës 1 të këtij neni, brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji. 3. Ujërat e ndotura industriale me ngarkesë organike më të madhe ose të barabartë me 4000 nj.p., që nuk trajtohet në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe që gjenerohen nga industritë e përcaktuara sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni, veprimtaria e shkarkimit të tyre duhet të respektojë kushtet e lejes apo autorizimit mjedisor, ku përfshihen edhe kërkesat e	Pjesshëm	Pika 2 e nenit 107, parashikon bazën ligjore për përfrimin e plotë të Shtojcës III

				përcaktuara nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore lidhur me vlerat kufi të emetimeve në përputhje me dispozitat e neneve 79-95 të këtij ligji.		
Neni 13, pika 2	Deri më datë 31 Dhjetor 1993 autoriteti kompetent ose organi përkatës në cdo shtet Anëtar duhet të vendosi kërkesat e përshtatshme me natyrën e industrisë në lidhje me shkarkimet e këtyre ujërave të ndotura.		Neni 107, pika 5	5. Kërkesat e përcaktuara nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore lidhur me vlerat kufi të emetimeve duhet t'i përshtaten natyrës së industrisë përkatëse.	plotë	
Neni 14, pika 1, fjalia e parë	Llumi që del nga trajtimi i ujit të ndotur duhet të ri përdoret kur është e përshtatshme.		Neni 108, pika 1	1. Autoritetet përkatëse të vetëqeverisjes vendore sigurohen që llumi i gjeneruar nga trajtimi i ujërave të ndotura urbanë të ripërdoret kurdo që shihet e përshtatshme.	plotë	
Neni 14, pika 1, fjalia e dytë	Mënyrat e asgjësimit duhet të minimizojnë efektet negative në mjedis.		Neni 108, pika 2	2. Autoritetet përkatëse të vetëqeverisjes vendore sigurohen që largimi i llumit të ketë sa më pak ndikime negative në mjedis.	plotë	
Neni 14, pika 2	Autoritetet kompetente ose organet përkatëse duhet të sigurojnë që përpara datës 31 Dhjetor 1998 asgjësimi i llumit nga impinatet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, është subjekti i rregullave të përgjithshme ose regjistrimit ose autorizimit.		Neni 108, pika 3	3. Veprimtaria e largimit të llumit të gjeneruar nga trajtimi i ujërave të ndotura rregullohet sipas legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve.	plotë	
Neni 14, pika 3	Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që deri më datë 31 Dhjetor 1991 asgjësimi i llumit		Neni 108, pika 4	4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës për	plotë	

	nga ujërat sipërfaqësor nga shkarkimi i anijeve, nga shkarkimi i naftës-jellësve ose më mjete të tjera është eliminuar.			dhënien e lejeve për largimin e llumit nga anijet në sipërfaqe ujore, kur kjo veprimtari kryhet përmes tubacioneve apo formave të tjera të ngjashme, marrin masa për rregullimin e kësaj veprimtarie deri në ndalimin e plotë të tij.		
Neni 14, pika 4	Deri në eliminimin e formave të asgjësimit të përmendura në paragrafin 3, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që sasia totale e lëndëve toksike, e vazhdueshme ose e materialeve bio akumuluese në llumë asgjësuar nga ujërat sipërfaqësore është i lecnuar për asgjësim dhe reduktuar progresivisht.		Neni 108, pika 5	5. Deri në arritjen e ndalimit të plotë të largimit të llumit nga anijet në sipërfaqe ujore përmes tubacioneve apo formave të tjera të ngjashme, sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij neni, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës për dhënien e lejeve përkatëse, duhet të sigurojnë, që veprimtaria të kryhet me leje ku përcaktohet sasia totale e shkarkimit të lëndëve toksike, të qëndrueshme apo të bioakumulueshme të pranishme në llum, si dhe reduktimin e kësaj veprimtarie në mënyrë progresive.	plotë	
Neni 15, pika 1, paragrafi i parë	Autoritet kompetente ose organet përkatëse duhet të monitorojnë: - Shkarkimet nga impiantet e trajtimit të urjrave të ndotura, të verifikojnë përmbushjen e kërkesave të Aneksit I.B në përputhje me		Neni 109, pika 1, gërma (a)	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përmes informacionit të marrë nga institucioni përgjegjës për montorimin e mjedisit, merr masa për kontrollin e: a) shkarkimeve nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e	plotë	

	procedurat e kontrollit të përcaktuara në Aneksin I.D,			lejes përkatëse në zbatim të neneve 97-108 të këtij ligji;		
Neni 15, pika 1, paragrafi i dytë	- Sasitë dhe përbërjen e llumit të asgjesuar nga ujërat sipërfaqësore.		Neni 109, pika 1, gërma (b)	b) sasive dhe përbërjes së llumit që shkarkohet në sipërfaqe ujore.	plotë	
Neni 15, pika 2	Autoritet kompetente ose organet përkatëse duhet të monitorojnë ujërat subjekt I shkarkimeve nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe shkarkimet direkte sic janë përcaktuar në Nenin 13 në rastet kur mund të pritët që mjedisi marrës mund të ndikohet në mënyrë të konsiderueshme.		Neni 109, pika 2	2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron ushtrimin e kontrollit të shkarkimeve nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbanë dhe shkarkimet e drejtpërdrejta, në përputhje me nenin 107 të këtij ligji në rastet kur pritët që mjedisi pritës do të ndikohet në mënyrë të konsiderueshme.	plotë	Neni 13 i Direktivës është transpozuar nga nga neni 107, pikat 1, 2, 3 dhe 5 të projektigjit
Neni 15, pika 3	Në rastin e një shkarkimi subjekt I dispozitave të Nenit 6 dhe në rastin e llumit të asgjesuar nga ujërat sipërfaqësore, Shtetet Anëtare duhet të monitorojnë dhe të kryejnë cdo studim tjetër përkatës për të verifikuar që shkarkimi ose asgjësimi nuk ndikon negativisht mjedisin.		Neni 109, pika 3	3. Në rast shkarkimesh që janë subjekt i dispozitave të nenit 116 të këtij ligji dhe në rast të shkarkimit të llumit në sipërfaqe ujore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron kontrollin e shkarkimeve dhe kryerjen e studimeve relevante për të verifikuar që llumi nuk ndikon negativisht në mjedis.	plotë	
Neni 15, pika 4	Informacioni i mbledhur nga autoritetet kompetente ose organet përkatëse në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 duhet të ruhet në Shtetin Anëtar dhe ti vihet në dispozicion Këshillit		Neni 109, pika 4	4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore duhet të vendosë në dispozicion të publikut informacionin e mbledhur në përputhje me pikat 1 – 3 të këtij neni.	plotë	

	Brenda gjashtë muajve nga marrja e një kërkesë.					
Neni 16	Pa cënuar implementimin e Direktivës së Këshillit 90/313/KEE të datës 7 Qershor 1990 për të drejtën e informacionit për mjedisin (1), Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që cdo dy vjet autoritetet ose organet përkatëse të publikojnë raporte të gjëndjes për asgjësimin e ujërave të ndotura urbane dhe llumit në zonat e tyre. Këto raporte duhet të transmetohen Komisionit nga Shtetet Anëtare sapo ato të publikohen.		Neni 110	Ministria përgjegjëse për mjedisin harton raportin përmbledhës për gjendjen aktuale të shkarkimit të ujërave të ndotura dhe largimin e llumit në territorin e Shqipërisë, e publikon atë dhe e dërgon pranë Agjencisë Evropiane të Mjedisit çdo 2 vjet, duke filluar nga botimi i raportit të parë.	plotë	